Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica	**16.06.2023**	**29.06.2023**	**2023/0383**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.06.2023, OE "Ideal Shala B.I."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0383, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "AUTOTRADE" Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "FURNIZIM ME PJESË PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150" me nr. të prokurimit: "214-23-1737-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës:kontratë publike kornizë me një OE, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 170 000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Njoftimi për kontratë 07.03.2023

Hapja e Ofertave 18.04.2023

Njoftim mbi vendimin e AK-së- 23.05.2023

Kërkesa për Rishqyrtim 29.05.2023

Përgjigjja ndaj kërkesës për Rishqyrtim 01.06.2023

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Deklaratë detale mbi faktet dhe Argumentet

Te nderuar zyrtare te OSHP-se po ju drejtohemi me kete ankes per AK-Policia e Kosoves .

Lidhur me njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues per dhenje kontrate sipas sistemit te E-proku te pranuar me 23.05.203 per tenderin: FURNIZIM ME PJESË PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150 kompania fituese AutoTrade shpk vlera e parashikaur e aktivitetit 170,000.00€ dhe ofi fianciare e peshaur 17,297.39€.

Pas kereses tone per qasje ne dokumentacion kemi pranuar ne Cd dokumentat e kompanis fituese OE-AutoTrade shpk ku kemi pare se dokumentacioni I cili eshte dorezuar nuk ka qenen ne perputhje me kerkesat e Ak-se ne dosejn e tenderit FTD. GjaTE shfletimit te dokumentacionit te OE te rekomanduar kontrate kemi hasur dhe kemi konstatu qe I njeti nuk I permbushe kerkesat e autoriteit kontraktues Poli Kosoves sipas njoftimit per kontrate dhe FTD-se .Ne vazhdim do ju pasqyroj te gjitha te gjeturat qe OE rekomanduar per kontrate nuk I permbushe .

Autoriteti kontrakues ka vepriuar ne kundershtim me LPP ne dhe RRUOPP dispozitat e shkelura na AK paraqesim ne vazhdim

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Shkelje e Nenit 1, Nenit 7,Nenit 28, dhe Nenit 59

Ne njoftimin per kontare dhe dosjen e tenderit kerkesat e AK –se kane qene pika AK- Policia e Kosove kerkuar te pika Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Shkelje e Nenit 1, Nenit 7,Nenit 28, dhe Nenit 59

Ne njoftimin per kontare dhe dosjen e tenderit kerkesat e AK –se kane qene pika AK- Policia e Kosoves k kerkuar te pika Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2:

- Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme **për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate)** ne vlere prej minimum 200,000.00€;

- **Dëshmi 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate)** e nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit në vlerë minimum Pjesa 1 200,000.00€; Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referen pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet t dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshua nga autoriteti i tillë.

Ne kemi verejtur se OE –fitues nuk I ka permbushe kerkesat sipas njoftimit per kontare dhe dosj tenderit

OE –Fituese ka bashkangjitur referencat te cilat jane pranuar mbas dates se njoftimit per kontrate nuk jane per kontratat e ofruara dmth nuk I takojne kontratave te cilat I ka dorzuar shih me poshte argumentet .

- Referenca EULEX eshte pa date ,pa vlere ,pa nr te kontrtates ku eshte shenuar vetem vit do te thote ka bashkangjitur kontrata , refrenca te ndryshme qe nuk dihet asgje per kontra se a jane perfunduar me sukses apo jo qe nuk I takojn te njejtes refrence , ku sipas kerk referenca eshte e pa vlefshme paisi qe kerkesa e Ak –se e nënshkruar dhe vulosur nga C dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autorit përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit në vlerë minimum Pjesa 1 200,000.0 Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca po kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorë fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshuara autoriteti i tillë shi argumentet 1- lista e kontratav dhe referencave eulex.

Referenca United Nations data e refences 22.03.2023 eshte date pas njoftimit per kontrates ku sip AK-se eshte e pa vlefshme ,po ashtu te kjo refrence eshte shenuar nje numer I kontrates I cili nuk kontratave te cilat jane bashkangjitur ,kjo reference po ashtu eshte pa vlere, ku flitet per vitin 201 takon listes se kontratave te paraqitura me oferten e dorezuar gjithashtu asnje kontrate te dorzuar oferte ne AK per UNMIK nuk korrespodojn me kete reference ku mund te shihni qe ka vendosur kontrata te viteve 2018-2019 te cilat nuk llogariten sipas kerkse se Ak pasi qe ato jane te viteve te jane 3 vitet e fundit . AK ka vepruar ne kundershtim me LPP-ne neni 59 pasi gjate versimit dhe k ka pranuar referenca edhe jashte kerkeses se njofimit per kontrate dhe dosjes se tenderit

- Referenca Vitaminka ku data e refrences eshte 07.04.2023 eshte date pas njoftimit per kontrate ku sipas kerkeses se AK-se eshte e pa vlefshme kontrata nuk ka furnizime vetem sherbime te mirmbajtjes kerkese e AK:**Furnizim me pjese per automjete Toyota Landcruiser 150**, **Dëshmi 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate)** e nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit në vlerë minimum Pjesa 1 200,000.00€; Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë.

- Referenca Avis Budget ku data e refrences eshte 07.04.2023 eshte date pas njoftimit per kontrate ku sipas kerkeses se AK-se eshte e pa vlefshme , kontrata nuk ka furnizime vetem sherbime te mirembjtjes kerkesa e AK –se eshte **:Furnizim me pjese per automjete Toyota Landcruiser 1 ,Dëshmi 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate)** e nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit në vlerë minimum Pjesa 1 200,000.00€; Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referen pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet t dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshua nga autoriteti i tillë.

- Referenca Hej Taxi Shpk ku data e refrences eshte 07.04.2023 eshte date pas njoftimit per kontra ku sipas kerkeses se AK-se eshte e pa vlefshme ,kontrata nuk ka furnizime vetem sherbime te mirembajtjes. kerkesa e AK –se**:Furnizim me pjese per automjete Toyota Landcruiser 150 , Dëshmi 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate)** e nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit në vlerë minimum Pjesa 1 200,000.00€; Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referen pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet t dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshua nga autoriteti i tillë.
- Po ashtu tek lista e qmimeve katergoria A Ak ka nda me 50% peshim qe do te thote se keto pjese do te implementohn 50% te kesaj kontrate ku OE I rekomanduar per kontrate ka afruar qimim shume te larta ne krahasim me qmimet e ofertes tone dhe qimet e tregut .Ne rast te implementimi te kesaj kontrate AK Policia e Kosves do te demtohet financiarisht ,andaj kerkojm nga OSHP qe trajtohen nr mrnyre te drejte te gjitha faktet dhe pretendimet ton ate paraqituar ne kete ankese .

Vlen te ceket se Ak-Policia e Kosove ka bere pyetje sqaruese rrethe kerkese se kontratve dhe refren fituese nuk ka ofruar asnje deshmi bindese sipas kertkesave qe ju eshte kerkuar nga AK Policia e Kos sse OE fitues nuk ka deshmuar asgje sipas sqarimit te cilin e ka derguar te AK-Policia e Kosoves .Ne j bashkangjitur te gjitha deshmit lidhur me kete aktivitet per Kontratat dhe Referencat ku OE –nuk ju asnje argument sipas sqarimit te kerkuar nga AK-Policia te dates :28.04.2023

Sa I perket sqarimeve te cailat jane kerkuar nga AK me daten 11.05.2023 te njejtat ju kemi ofruar d miaftueshme ashtu sig edhe ka kerkuar AK- Policia e Kosoves. Ne kemi OE kemi permbushur te gjith

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik-Çertifikata Regjistrimit të Biznesit (nëse OE i jashtëm shpallet fitues duhet te regjistroj përfaqësinë ne Kosovë para nënshkrimit te kontratës)	**Dëshmi 1 Çertifikata e Regjistrimit të Biznes e leshuar nga Agjensioni per Regjistrimin e Bizneseve ne Ministrine e Tregtise dhe Industrise (kopje)**
Kërkesa 2 Certifikata e TVSH-se (për Operatoret Ekonomik vendor)	**Dëshmi 2 Certifikatën e TVSH-së (kopje) (pë Operatoret Ekonomik vendor)**
Kërkesa 3 Certifikata me Numër Fiskal (për Operatoret Ekonomik vendor)	**Dëshmi 3 Numri Fiskal i lëshuar (Kopje) (për Operatoret Ekonomik vendor)**
Kërkesa 4 Autorizim i lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i prodhuesit (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë) ne	**Dëshmi 4 Autorizim i lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i prodhuesit (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë)**

kohëzgjatje te kontratës prej 36 muaj, autorizimi duhet te jetë nga prodhuesit ose distributori i prodhuesit të pjesëve rezerve ose prodhuesi i veturës ose distributori i autorizuar i prodhuesit të veturës. Nëse ka me shumë se një prodhues atëherë duhet autorizime për te gjithë prodhuesit (me te dhëna mbi prodhuesin, si adresa, nr. tel, email,).	**ne kohëzgjatje te kontratës prej 36 muaj, autorizimi duhet te jetë nga prodhuesit ose distributori i prodhuesit të pjesëve rezerve ose prodhuesi i veturës ose distributori i autorizuar i prodhuesit të veturës. Nëse ka me shumë se një prodhues atëherë duhet autorizime për te gjithë prodhuesit (me te dhëna mbi prodhuesin, si adresa, nr. tel, emai).**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet te dëshmoj te hyrat e përgjithshme se bashku për tre vitet fundit 230,000.00€;	**Dëshmi 1 OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vit e fundit (2020, 2021, 2022) .**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) ne vlere prej minimum 200,000.00€;	**Dëshmi 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit në vlerë minimum Pjesa 1 200,000.00€; Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë**
Kërkesa 2 OE është i obliguar ta beje montimin e pjesëve nën garancion brenda territorit të Prishtinës ose një distancë jo ma te largët se 15 kilometra nga Flota Operative bazuar në rrugën me të afërt tokësore të asfaltuar. OE i jepet mundësia qe te lidhe kontrate me ndonjë servisë i cili gjendet brenda rrezes (15km).	**Dëshmi 2 OE duhet te sjelle Deklarate mbi Lokacioni i servisit (adresa), Flota Operative - Lokacioni i OE. Po qesë OE ka objektin e servisit me qira duhet te prezantohet edhe marrëveshja mes operatoreve. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar..**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Policia e Kosovës shpërblen me kontratë kompaninë " AUTOTRADE " SH.P.K., me çmim të poentuar: 17,297.39 €.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Ideal Shala B.I.**

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

Eksperti Shqyrtues, konstaton që kërkesë e dosje së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) ne vlere prej minimum 200,000.00€",*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar*: "Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e*

prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit në vlerë minimum 200,000.00€;

Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë".

Lidhur me referencën e Ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë e cila është lëshuar nga "EULEX", eksperti shqyrtues sqaron se në këtë referenc theksohet që "EULEX" bashkëpunon me kompaninë Autotrade që nga 2008, mirëpo të dhëna të tjera si data e lëshimit të referencës,shuma e kontratës dhe lloji i kontratës nuk janë theksuar, gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar 3 kontrata me "Eulex" të cilat janë një vjeqare. Kontrata e ofruar është me dt. 14.06.2019 dhe mbanë shumën 250 000.00 Euro, kontrata tjetër ështe e lidhur me dt. 25.06.2020 dhe mbanë shumën 280 000.00 Euro dhe kontrata tjetër e lidhur me dt.01.06.2022 dhe mban shumën 280 000.00 Euro.

AK-ja i ka kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë ku përgjigjja e tyre ka qen se: "*...ndërsa në referencë nuk e ka cek shumën pasi që është kundër rregullave interne të privatësisë*". Eksperti shqyrtues, thekson se pavarësisht arsyetimit të OE të rekomanduar për kontratë, AK konform Nenit 72.3 të LPP-së është dashur të kërkoj nga "Eulex", sqarime, nëse të njejtit kanë përfunduar kontratë të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit dhe të verifikoj se sa është shuma e kontratës. Andaj pretendimi i OE ankues për referencën e Eulex është pjesërisht e bazuar.

Përgjigjje për referencen "United Nations"

Ne lidhje me referencen e United Nations është e lëshuar pas njoftimit për kontratë, dhe kjo kontratë ka të shënuar një numër të kontratës i cili nuk ju përket kontratave të cilat janë bashkangjitur,

Lidhur me referencën e Ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë e cila është lëshuar nga "UNITED NATIONS", eksperti shqyrtues sqaron se kjo referencë është lëshuar me dt.22.03.2023, por kjo datë mund të pranohet për shkak se është para hapjes së ofertave, mirëpo në referencë figuron që kontrata është nga periudha 2010 deri me tani. Gjithashtu numri i kontratës i paraqitur në referencë nuk është i njejtë me numrin të paraqitura në kontrata.

Gjithashtu nga "UNMIK" është paraqitur kontrata me OE "Auto trade sh.p.k", e cila është në periudhë kohore nga 14 Tetor 2018 deri 13 Tetor 2019.

kontrata tjetër është me periudhë kohore nga 14 Tetori 2019 deri 13 Tetor 2020, dhe

kontrata tjetër është 14 Tetor 2020 deri 13 Tetor 2021.

Eksperti Shqyrtues, thekson se Referenca e lëshuar nga United Nations nuk e ka të specifikuar

shumën e cila është kërkesë e dosjes së tenderit. Gjithashtu kontratat e "UNMIK" jo të gjitha janë të pranueshme për faktin se disa janë të përfunduara më shumë se sa tre vite nga njoftimi për kontratë.

Andaj, eksperti shqyrtues, vlerëson se AK është dashur konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ti kërkojë sqarime institucionit i cili e ka lëshuar referencën dhe të vërtetoj shumën e realizimit të kontratave në periudhë tre vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, me që ky institucion ka nënshkruar kontratat të cilat janë të bashkangjitura në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Përgjigjje për referencen "Vitaminka"

Referenca Vitaminka për të cilën OE ankues thekson se data e referencës është pas datës së njoftimit për kontratë, dhe kjo kontratë ka vetëm shërbime dhe nuk ka furnizime, eksperti shqyrtues thekson se kjo referencë edhe pse e ka datën pas njoftimit për kontratë është para hapjes së ofertave dhe kjo është e pranueshme për shkak se mund të verifikohet ashtu siç e parasheh dispozita e nenit 72.3 e LPP-së, ndërsa sa i përket se kjo referencë nuk ka furnizime, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit është kontrata të njejta ose të ngjajshme, andaj meqë AK ka përdorur lidhëzën OSE ather janë të pranushme edhe shërbime të ngjajshme.Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Përgjigjje për referencen "Avis Budget"Referenca "Avis Budget" ku OE ankues thekson se kjo referencë është pas datës së njoftimit për kontratë, ku sipas kërkesës së AK-së është e pa vlefshme, kjo kontratë nuk ka furnizime por mirëmbajtje, eksperti shqyrtues sqaron se referenca është lëshuar më dt. 07.04.2023 e cila është pas njoftimit për kontratë mirëpo referenca është para hapjes së ofertave dhe mund të verifikohet në mënyrë Objektive sipas nenit 72.3 të LPP-së, ndërsa në lidhje me natyrën e kontratës, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit thekson se kontrata të natyrës së njejtë ose të ngjajshme, andaj për vetë faktin se AK ka lejuar edhe kontrata të ngjajshme mund të konsiderohet e pranueshme referenca. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Përgjigjje për referencen "Hej Taxi Sh.p.k"

Referenca "Hej Taxi Sh.p.k", OE ankues thekson se është pas njoftimit për kontratë dhe kjo kontratë nuk ka furnizime por vetëm shërbime. Eksperti Shqyrtues, sqaron se kjo referencë është lëshuar me dt. 07.04.2023 e cila është pas datës së njoftimit për kontratë, mirëpo është para hapjes së ofertave dhe kjo mund të verifikohet konform nenit 72.3 të LPP-së. Ndërsa në lidhje me natyrën e kontratës, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit thekson se kontrata të natyrës së njejtë ose të ngjajshme, andaj për vetë faktin se AK ka lejuar edhe kontrata të ngjajshme, gjithashtu në sqarimet e kërkuara nga AK për OE i rekomanduar për kontratë i njejti i përgjigjet si në vijim:"... *po ashtu me kontratën që kemi bëhet furnizimi i pjesëve sipas nevojës dhe jo vetëm servisimi i rregullt por furnizim si dhe riparime tjera*".

Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pa bazuar.

Ndërsa sa i përket listës së çmimeve kategoria A, AK-ja ka nda 50% peshim që do të thotë se këto pjesë do të implementohen 50% e kësaj kontrate, ku OE i rekomanduar ka ofruar çmim shumë të larta në krahasim me çmimin e ofertës tonë.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se AK ka respektuar dispoziten e nenit 61 të LPP-së, dhe i ka kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë ku i njëjti me dt. 11.05.2023 i përgjigjegj AK-së, ku i ka arsyetuar çmimet, Andaj eksperti shqyrtues, vlerson se pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar për faktin se AK është bindur me përgjigjjen e dhënë nga OE ankues.Pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pa bazuar dhe rekomandon të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Ideal Shala B.I.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Gjemajli Bellanica

Gj. Bellanica